

**STATUTI dhe Akt Themelimi
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“OXFORD MEDICAL” Sh.p.k.**

Sot më datë 20.04.2021 (dy mijë e njetë e një),

Z. Maren Ruka, i lindur me 28.07.1984, dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me ID I40728020D, dhe Z. Robert Kadiu i lindur me 28.01.1977, i identifikuar me pasaportë H70128004F përdorues i cel: 0674761193; e-mail: **rukamaren@gmail.com**

Mbështetur në legjislacionin Shqiptar, kryesisht në ligjin Nr. 9901 dt 14.04.2008. “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar dhe të akteve të tjera ligjore në fuqi ka përpiluar dhe nënshkruan sot Statutin e Shoqërisë si më poshtë vijon:

**KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria “OXFORD MEDICAL” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, veprimtaria e së cilës do të rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni në fuqi.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Ky Statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1. Emërtimi i Shoqërisë është “OXFORD MEDICAL” Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria “OXFORD MEDICAL” Sh.p.k. krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

Laborator klinik, biokimik, serologjik, imunologjik, gjenetik, mikrobiologjik, histopatologjik, citologjik Shërbime mjeksore diagnostikuese imazherike, kuruese, obstetrik-gjinekologji, kardiologji, endokrinologji neurologji, pediatri dhe kujdes mjeksor, terapi mjeksore, shërbime të specializuara mjeksore të tjera dhe infermierore. Importim dhe tregtim të kитеve, reagenteve, pajisjeve mjeksore, pajisjeve laboratorike, implanteve të ndryshme, ortopedike, kranio-faciale, vertebral, angio kateter, lende hemostatike, instrumenta kirurgjikal, imazherik, mjeteve ndihmese deambulator, orteza. Blerje e lendeve farmaceutike, para farmaceutike. Shërbime konsulence mjeksore online.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është në: **Klos, Bulevardi Kryesor i Qytetit, ish Restoranti i Klosit, kati i dytë.**
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Organit administrativ ka kompetencën të plotë të vendosë vetë për hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar në kohë.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije leke) lekë, i formuar nga ortakët themelues, i ndare në 2 Pjese.
- 6.3. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet si me poshte:
 1. Z. Maren Ruka, zoteron 1 (një) pjese te kapitalit, ose ndryshe 48 % te kapitalit te shoqerise, dhe 48.000 (dyzete e tete mije) leke dhe Z.Robert Kadiu zoteron 1 (një) pjese te kapitalit, ose ndryshe 52 % te kapitalit te shoqerise, dhe 52.000 (pesedhjetë e dy mije) lek

Neni 7 – Rritja e kapitalit themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rritja e kapitalit behet vetem me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 7.2. Asambleja e përgjithshme merr vendime të vlefshme, për rritje të kapitalit themeltar vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar. Zvogëlimi i kapitalit behet me vendim unanim të Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 8.2. Asambleja e përgjithshme merr vendim të vlefshme për zvogëlim të kapitalit themeltar vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të Ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.

Neni 9 – Fitimi dhe Kalimi i Kuotave

- 9.1 Fitimi i kuotave nëpërmjet trashëgimisë është i pa kushtëzuar nga vullneti i ortakeve të tjerë apo shoqërisë.
- 9.2. Është i lirshëm dhe i pakushtëzuar kalimi i kuotave tek seicili trashëgimtar ligjorë i radhës së pare (fëmijë dhe bashkëshortë) si edhe tek shoqëri, persona juridikë të zotëruar 100% nga zotëruesi i kuotës që transferohet.
- 9.3. Kalimi i kuotave tek persona të tjerë përjashto sa parashikohet ne 9.1 dhe 9.2 më sipër kushtëzohet nga e drejta e parablerjes se ortakeve.
 - 9.3.1. Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje dhe/ose me Leter Njoftimi nepermjet adreses elektronike (në vijim “Njoftimi”), (a) numrin e kuotave të ofruara; (b) emrin e blerësit/përfituesit; (c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim; (d) modalitetet e pagesës; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjerë të cilët do të ushtrojnë të

drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

- 9.3.2. Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 9.3.3. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 9.3.4. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'u transferohen të tretëve sipas çmimit të specifikuar në të.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 10 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 10.1. Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 10.2. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.
- 10.3. Asambleja e ortakëve vendos ne perputhje me legjislacionin ne fuqi për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 10.4. Asambleja e ortakëve vendos ne perputhje me legjislacionin ne fuqi persa i perket emerimit dhe largimit te administratorëve, shpërblimeve, eksperteve kontabel e likuiditoreve, per politikat tregetare te shoqerise; per mbikqyrjen e politikave tregetare te aplikuara nga administratorët, perfaqesimi ne gjykate dhe ne procedime te tjera per administratorët e tjere si dhe ne lidhje me cdo vendim tjetër te parashikuar ne Statut ose nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 11 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 11.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij. Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.
- 11.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 11.3. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim vetëm për një pjesë të kapitalit që zotëron.

Neni 12 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 12.1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe te inventarit.
- 12.2. Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kërkeses që do ti drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja thirret nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Poste elektronike.

- 12.3 Lajmerimi do t'u dërgohet ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
Në rast njoftimi me poste elektronike, përveç afatit 7 ditor jepet edhe një periudhë shtesë prej 5 (pesë) ditësh kalendarike. Njoftimi per seicilin ortak dërgohet ne adresat respektive pershkruar ne hyrje te ketij akti apo te depozituara më vonë prane shoqërisë.
Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi rendin e ditës që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.
- 12.4. Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 7 (shtate) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 12.5. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes.
- 12.6. Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nese Asambleja mblidhet ne seline e shoqerise. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit e te vendmbajtjes në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 12.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 (tridhjet) të kapitalit themeltar.
- 12.8 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 12.9 Per drejtimin e puneve ne çdo Asamble zgjidhet nje Kryetar, ortak ose ndonjë përsôn tjetër jo-ortak i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 12.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Ortaket prezent.

Neni 13 – Njoftimi

- 13.1. Njoftimi i ndersjellte ndermjet ortakëve, Administratorit, Personelit drejtues dhe bashkepunetoreve te shoqerise, do te realizohet nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Poste elektronike: d) njoftimit ne faqen zyrtare elektronike te shoqerise;
- 13.2 Njoftimi me poste elektronike do të konsiderohet i kryer me kalimin e një afati total prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e nisjes se e-mailit nga njoftuesi. Ky aftat përbehet dhe është shumatore e afatit minimal ligjor prej 7 (shtatë) ditë dhe afatit prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të lënë në dispozicion per konsultim të emailt.
- 13.3. Njoftimi per seicilin ortak dërgohet ne adresat respektive pershkruar ne hyrje te ketij akti. Administratori, Personeli drejtues dhe bashkepunetoret e kontraktuar nga shoqeria duhet te depozitojne adresen e tyre elektronike ne shoqeri;
- 13.4. Njoftimi nepermjet faqes zyrtare elektronike te shoqerise konsiderohet i kryer me kalimin e afatit të parashikuar në ligj.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet **Z.Maren Ruka**
- 14.3. Administratori emerohet ne kete detyre per nje afat kohor 5 (pese) vjecar.

- 14.4. Administratori i shoqërise gezon te drejtat e administrimit te zakonshem te shoqëise.
- 14.5 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.
- 16.3 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria mund te priset në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat

përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Per çfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Ky akt hartohet ne 2 kopje originale, me të njejten vlere ligjore, nje kopje depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

ORTAKET THEMELUES

1. Z. Maren Ruka



2.Z.Robert Kadiu

